



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 92-të, të mbajtur më 11.09.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi I regjistruar sipas numrit 12-2997/1 nga 20.06.2023 , lidhur me delegimin e punëtorit në ----- ISHPKNJP Shkup në SHA ----- Shkup, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë sepse lënda ka të bëjë me marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet dy personave juridikë.

Lënda me numër 12-2997/1 nga 20.06.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 20.06.2023, është dorëzuar denoncim në lidhje me delegimin e personit të punësuar në ----- SHPKNJP Shkup në ASH ----- dhe është formuar lënda me numër 12-2997/1 nga 20.06.2023.

Në denoncim, parashtruesi i denoncimit thekson se me datë 15.03.2023 është lidhur Marrëveshja për bashkëpunim afarist dhe teknik ndërmjet ----- Shkupit dhe SHA ----- Shkup, në të cilin ishte përcaktuar se pala e parë kontraktuese dmth - ----- do të delegojë 5 (pesë) persona nga radhët e të punësuarve te pala e dytë kontraktuese, në rastin e SHA ----- Shkup.

Kërkuesi ka qenë një nga personat të cilët kanë qenë objekt i kontratës së përmendur dhe i cili, siç thuhet, ka qenë i pakënaqur me këtë kontratë si dhe me ndarjen e vendit të punës në SHA ----- Shkup.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se në rastin bëhet fjalë për pretendime që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent, por janë pretendime lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet dy personave juridikë, pas së cilës ka konstatuar se. nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Bazuar në sa më sipër/KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar :

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: K.Z

Miratoi: S.P.D anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska**
